




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
Direkcija za Kulturę Omladinu i Sport
Department of Culture Youth and Sports

Thirrje Publike

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe Individëve në fushën e Kulturës

1. Komuna e Skenderajit përkatësishtë Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Komunën e Skenderajit, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës në Komunën e Skenderajit.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte /programet e tyre për Aktivitetin kulturor historik, i paraparë me rregulloren Komunale për ndarje të subvencioneve nr.01-400/01-0051689/20 të datës 04.12.2020 siç është Festivali Folklorik **“Rapsodia Shqiptare,”** që njihet si aktivitet kryesor tradicional i Komunës së Skenderajit I cili mbahet me datat **26,27 dhe 28 Nëntor** Edicioni i 20-të
3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë vetëm me nga një projekt në kuadër të kulturës i cili do të përfshijë dhe kontribuojë në promovimin e aktiviteteve të paraparë me pikën 2 të kësaj thirrje publike.
4. Shuma e mbështetjes financiare është 22,000.00 Euro

Vlera Totale e Thirrjes Publike është 22,00.00 Euro

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga dita e publikimit të thirrjes publike, përkatesisht dita e fillimit është 07/10/2025, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është me datën 27/10/2025.

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara ne regjistrin e Organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Skenderajt dhe të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike, periodha e zbatimit të projektit është fundi i vitit aktual.

OJQ-të aplikuese duhet të deshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës, si dhe të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore. Nëse kanë qenë përfituese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna Skenderaj, të justifikojnë mjetet e shpenzuara duke dorëzuar raportin financiar.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për veptra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme. Të njëjtat dëshmi duhet të i dorëzojë edhe personi fizik i cili është përfitues i mbështetjes financiare.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Skenderajt kk.rks-gov.net/Skenderaj.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në zarf të mbyllur në arkiven e komunës në adresës: **“Komuna Skenderaj, rruga 28 Nentor 41000”- Skenderaj**

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në **Udhëzimin për aplikuesit e thirrjes publike**.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e percaktuara të thirrjes publike.

Lista e dokumenteve që duhet t'i bashkangjitet formularëve nga ana e aplikuesve janë si vijon:

Për OJQ-të:

- Çertifikaten e regjistrimit të OJQ-së
- Çertifikata e nr. Fiskal
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare)
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së
- Vërtetimin/Marrëveshjen që OJQ nuk ka obligime tatimore (nga ATK)
- Deklaratën për financim të dyfishtë.

Vërejtje/Kujdes: Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: komuna.skenderaj@rks-gov.net

Skenderaj, 07.10.2025

Drejtori E K/
Komuna e Shkupit
Alban Berisha



UDHËZUES PËR APLIKANTËT

Thirrje Publike nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport Komuna Skenderaj për Organizimin e Festivalit “Rapsodia Shqiptare” – Edicioni i 20-të, 2025

1. Qëllimi i Thirrjes

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Skenderajt shpall thirrje publike për përzgjedhjen e organizatorit të Festivalit “Rapsodia Shqiptare” – Edicioni i 20-të, 2025, me qëllim të promovimit të trashëgimisë kulturore shqiptare, ruajtjes së traditës së rapsodisë dhe mbështetjes së artistëve vendorë dhe kombëtarë.

2. Të Drejtë Aplikimi

Për të aplikuar kanë të drejtë

- OJQ-të dhe organizatat kulturore të regjistruara ligjërisht në Kosovë programi i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës , projekte që kontribuojnë në zhvillimin e Kulturës në Komunën e Skenderajt

3. Dokumentet e Domosdoshme për Aplikim

Aplikuesit duhet të dorëzojnë këto dokumente:

1. Formularet e plotësuar të aplikimit (të ofruar nga DKRS);
2. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së / subjektit;
3. Planin e detajuar të organizimit të festivalit;
4. Përvojën paraprake në organizime të ngjashme;
5. Kopjen e ID-së së përfaqësuesit ligjor;
6. Çertifikata e nr.Fiskal
7. Vertetimi /Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së
8. Vertetimin/Marveshjen që OJQ nuk ka obligime tatimore (nga ATK)
9. Deklaratën për financim të dyfishtë
10. Çdo dokument tjetër mbështetës që dëshmon kapacitetin organizativ dhe financiar.

Formularët për plotësim mund ti shkarkoni në faqen e Komuna Skenderaj

<https://skenderaj.rks-gov.net>

4. Procesi i Pranimit dhe Shqyrtimit të Aplikacioneve

DKRS pranon aplikacionet gjatë periudhës së hapur të thirrjes. Pas afatit të aplikimit, komisioni profesional shqyrton dokumentet dhe verifikon përmbushjen e kriterëve. Aplikacionet e paplota ose jashtë afatit nuk shqyrtohen.

5. Kontraktimi dhe Dhënia e Fondeve

Pas përfundimit të vlerësimit, DKRS lidh kontratë me organizatorin fitues. Fondeve u bëhet transferimi sipas kushteve të kontratës dhe rregullave për financim publik.

7. Raportimi dhe Mbikëqyrja

Organizatori është i obliguar të paraqesë raportin përfundimtar financiar dhe narrativ, të sigurojë transparencë në përdorimin e fondeve publike dhe të lejojë përfaqësuesit e DKRS të monitorojnë aktivitetet.

8. Koha dhe Mënyra e Parashtrimit të Aplikacioneve

Afati për aplikim: 07.10.2025 deri më 27.10. 2025. Aplikacionet dorëzohen me postë ose personalisht në zarf të mbyllur në arkiven e Komunës në adresën ‘‘Komuna Skenderaj , rr.28Nentori 41000’’Skenderaj

9. Parashtrimi i Ankesave

Aplikuesit që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim në DKRS brenda 5 ditëve pune nga shpallja e rezultateve. Ankesat shqyrtohen nga komisioni përkatës sipas procedurave ligjore në fuqi.

10. Informata të Mëtejme

Për çdo informacion shtesë, aplikuesit mund të kontaktojnë në:

✎ Zyra e DKRS, Komuna e Skenderajit

Me respekt,

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
KOMUNA E SKENDERAJT

07.10.2025